

VENDIM
Nr. 179, datë 30.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE TË TJERË ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “g”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“g) punonjësit me arsim të lartë në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”;

b) në kreun 1.6, të lidhjes nr. 1, që përmendet në shkronjën “e”, të pikës 2, shtesa e pozicionit për pozicionin “Drejtor” bëhet 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj;

c) kreu 1.9, i lidhjes nr. 1, që përmendet në shkronjën “g”, të pikës 2, zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe me titull “Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) në rreshtin me numër rendor 1, të kolonës “Emërtimi”, të lidhjes nr. 7, që përmendet në pikën 2.3, shtohet emërtesa “teknik imazherie”;

d) kreu 2.2, i lidhjes nr. 2, zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

dh) lidhja nr. 10, që përmendet në pikën 20, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për këtë vit dhe fillojnë nga data 1 janar 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 1 (kreu 1.9)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË AGJENCINË E SIGURIMIT
TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR E SHOQËROR

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor i përgjithshëm	1	2%		100.900		Nga...deri Lekë
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie	1	2%		80.800		
3	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	1	2%		70.500		
4	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	1	2%		62.700		
5	Specialist në sektorët e përmbajtjes	1 ose 2	2%		61.000		
6	Specialist në sektorët mbështetës	1 ose 2 ose 3	2%		50.500		

Lidhja nr. 2 (kreu 2.2)

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PERSONELIN TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE NË QENDRËN KOMBËTARE TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PËR FËMIJËT

		PAGA MUJORE				
EMËRTIMI		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier		2%	0	53.200	5000
2	Infermier		2%	0	45.000	5000
3	Kujdestar		2%	0	39.550	5000

Lidhja nr. 10

SHPËRBLIMI PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT TË CAKTUAR NGA PALA TURKE NË SPITALIN RAJONAL "MEMORIAL" FIER

	Emërtimi i pozicionit	Masa mujore e shpërblimit në lekë
1	Nëndrejtor (mjekësor)	353,700
2	Nëndrejtor (ekonomik)	217,900
6	Shef shërbimi	368,800
4	Mjekë të specialiteteve të ndryshme	392,600
5	Farmacist	182,800
6	Kryeinfermier i përgjithshëm	293,800
7	Infermier	237,400
8	Përgjegjës sektori	216,000
9	Specialist	160,000
10	Teknik biomedikal	133,000
11	Teknik të shkencave mjekësore (profile të ndryshme)	237,000